



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:249330

Datë: 25.09.2024

Numri i dokumentit: 06207859

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Bekim Salihu, me praktikanten e kësaj gjykate Altinë Maliqi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses R.T.M. nga Ferizaj, të cilin me autorizim i përfaqëson avokati Abdurrahim Islami dhe B.I., kundër të paditurës Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Ferizaj, me objekt kontesti kompensim i pagave të 13-ta (trembëdhjeta), jashtë seancës gjyqësore me datë 25.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET, pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses R.T.M. nga Ferizaj, ashtu që **DETYROHET** e paditura Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Ferizaj, që paditëses në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë (13) për vitet 2018, 2019 dhe 2020 t'ia paguaj në shumën e përgjithshme shumën: 1,131.00 € (një mijë e njëqind e tridhjetë e një euro), me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë në gjykatë me data 16.11.2023 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës, në shumë prej 135€ (njëqind e tridhjetë e pesë euro), të gjitha këto afat prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit.

III.REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë për pagesën e pagave të 13 për vitet 2021 dhe 2022 në shumë prej 754.00€ (shtatëqind e pesëdhjetë e katër euro) si e pa bazuar.

A r s y e t i m

Paditësja përmes të autorizuarit të saj, me datën 16.11.2023, ka paraqitur padi kundër të paditurës Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Ferizaj, me të cilën ka kërkuar pagesën e pagave të 13-ta, për vitet 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022.

Më tej, në padi ka theksuar se paditësja ka themeluar marrëdhënie pune në Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Ferizaj, si në vërtetimet e bashkangjitura dhe që nga ajo kohë vazhdon të jetë e punësuar në këtë institucion në pozitën e njëjtë si infermiere. Paditësja edhe pse është e punësuar në këtë institucion dhe ka kryer gjithmonë në përpikëri detyrat e saj të punës, ka marrë gjithmonë vlerësime të kënaqshme dhe ndonëse grada dhe kualifikimi i përvojës së punës i njeh të drejtën në shpërblim të një page bazë në fund të vitit, të cilat i parasheh Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë me numër nr. 01-05-3815 e datës 12/06/2018 i cili në nenin 17 par. 2 thekson „ Punëmarrësi ka të drejtë në kompensimin e pagës së 13 (trembëdhjetë) për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit, një gjë e tillë nuk është realizuar. Paditësja ka tentuar që përmes rrugëve jashtëgjyqësore të bëjë realizimin e të drejtës së saj në marrjen e kompensimit në emër të një page të 13-të, përmes kërkesës drejtuar të paditurës, mirëpo deri më tani nuk kanë gjetur gjuhë të përbashkët me të paditurën, andaj duke u gjendur pranë kësaj shtate, paditësja përmes të autorizuarit të saj është detyruar ti drejtohet kësaj gjykate që të drejtën e saj ta realizoj përmes rrugëve gjyqësore. Andaj ka kërkuar që të aprovohet padia dhe kërkesë padia e Paditëses si e bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura nëpërmjet të autorizuarit të saj, ka paraqitur përgjigje në padi, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e Paditëses me arsyetimin se e paditura nuk ka mjete buxhetore për plotësimin e kërkesës si dhe paditëses nuk i takon kompensimi i pagave të 13-ta (trembëdhjetë) pasi që kontrata kolektive sektoriale nuk e obligon punëdhënësin për kompensimin e pagave të 13-ta por në bazë të mundësive buxhetore. Ka deklaruar se nuk është kontestues fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura duke u mbështetur në vërtetimet e punësimit të lëshuara nga e paditura. Më tutje ka kundërshtuar edhe kërkesëpadinë e paditësve për sa i përket kompensimit të pagës së 13-të, pasi që Kontrata Kolektive Sektoriale ka përfunduar afati kohorë i vlefshmërisë më datë: 12/06/2021 çka do të thotë se kjo kërkesë padia është jashtë marrëveshjes Kolektive Sektoriale. E paditura thekson se Paditësja i referohet nenit 17 par 2 të Kontratës Kolektive të Shëndetësisë i cili thekson “ Punëmarrësi ka të drejtë në kompensimin e pagës së 13 (trembëdhjetë) për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit,, dispozitë kjo e cila i referohet mundësive buxhetore të punëdhënësit, i referohet normave ligjore të karakterit dispozitiv dhe jo obligativ, andaj është tërësisht në mundësin buxhetore të punëdhënësit që duke vlerësuar mundësin buxhetore, të iu kompensohet paga e 13-të punëtorit. Andaj me që nuk ka pasur planifikim buxhetor të veçantë, e as mjete financiare që punëtorëve të i kompensohet paga e 13-të, konsiderojmë se në këtë drejtim nuk mund të detyroj të paditurën për kompensimin e pagës së 13-të.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të LPK-së për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi që nga përgjigja në padi rezulton qartas se kërkesëpapia e paditësit është e themeltë.

Gjykata pas analizimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqës, konstaton se në mes tyre është kontestuese baza juridike e kërkesëpadiisë.

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe vlerësimi i përgjigjes në padi, gjykata konstaton se në mes të palëve ndërgjyqës nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, megjithatë gjykata këtë fakt e vërtetoi sipas vërtetimeve të punësimit të paditësit të bashkangjitura në shkresa të lëndës.

Nga Kontrata e Punës për punësim në kohë të pacaktuar e datës 01/07/2013 dhe lista e pagave të lëshuar nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Ferizaj, gjykata ka vërtetuar se paditësja është e punësuar me orar të plotë në Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Ferizaj për kohë të pacaktuar, dhe për periudhën 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022.

Bazuar në provat e bashkangjitura në padi, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, si dhe dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë me numër nr. 01-05-3815 e datës 12/06/2018. Po ashtu bazuar në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 212/2023 të datës 09.10.2023, për shpërblimin e pagës së 13-të, të punëtorëve të shëndetësisë. Në nenin 55 par.1 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 ku përcaktohet se: “I punësuar ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”. Në nenin 20 par.2 të Ligjit nr. 04/I-125 për shëndetësi përcaktohet se: “*Institucionet e kujdesit shëndetësor që nuk janë pjesë e organizatës shëndetësore nga neni 68 i këtij ligji, në komunat ku kujdesi dytësor shëndetësor zbatohet në bazë të legjislacionit përkatës për vetëqeverisjen lokale, do të kenë kompetenca të zgjeruara për ofrimin e kujdesit shëndetësor sekondar, përfshirë këtu: Punësimin dhe pagesën e pagave dhe mëditjeve në pajtim me legjislacionin në fuqi*”.

Ndërsa neni 77 të këtij ligji përcakton se: *“Të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës e profesionistëve shëndetësorë si dhe kushtet e tyre të punës rregullohen me këtë ligj, ligjin e punës, dhe aktet e tjera ligjore në fuqi”*, ndërkaq bazuar edhe në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 212/2023 të datës 09.10.2023, për shpërblimin e pagës së 13-të, për punëtorët e shëndetësisë është paraparë se *“Punëtorët shëndetësor në kontestet nga marrëdhëniet e punës me kërkesat për shpërblimin e pagës së 13-të, në bazë të Kontratës Kolektive Sektoriale të datës 12/06/2018, kanë të drejtë në kompensimin e pagës së 13-të për çdo vite kalendarik, në vlerën e pagës bazë sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit.*

Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditëses si të punësuar pranë saj që të ia paguaj pagën e 13 në lartësinë e pagës bazë prej 377 € për çdo fundvit për vitet 2018, 2019 dhe 2020 që i bije 377 € paga bazë duke shumëzuar me 3 rezulton shuma e aprovuar në lartësi prej 1.331 € sikurse në pikën II të dispozitivit pasi që janë plotësuar edhe kushtet nga ana e paditësit siç parashihen në nenin 17 paragrafi 2 të Kontratës Kolektive Sektoriale. Nga interpretimi i dispozitave të Kontratës Kolektive Sektoriale, të nxjerra nga e paditura dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses sa i përket pagave të 13-ta është pjesërisht e bazuar sepse paditësi e gëzon të drejtën që në fund të çdo viti kalendarik, ta përfitoj si shpërblim, një pagë bazë në fund të vitit kalendarik përkatës.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese në lartësi prej 754€ në emër të pagës së 13 për vitet 2021 dhe 2022 gjykata ka vendosur në përputhje me nenin nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, pasi Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë me numër nr. 01-05-3815 e datës 12/06/2018 e cili ka hyrë në fuqi më datë 10.06.2018 me vlefshmëri 3 (tri) vite deri më 10/06/2021, andaj shuma e kërkuar për vitet 2021 dhe 2022 nuk kanë bazë ligjore për aprovim andaj si të tillë e ka refuzuar.

Andaj gjykata nëse merren parasysh shumat e caktuara sikurse në pikën I, II dhe III përputhen me shumën e kërkuara me anë të petitumit të kërkesëpadisë

Gjykata, vlerëson se e paditura ka detyrim sipas dispozitave të lartpërmendura, që t'i kompensoj paditësve pagat e trembëdhjeta pasi duke u bazuar në nenin 245 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-s), në të cilin përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë që ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*.

Prandaj gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura i ka mbetur borxh paditësit me aplikimin e dispozitave të lartcekura dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësve t'ua kompensoj shumat e gjykuara si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës në përgjigje në padi sa i përket pjesëve të aprovuara të kërkesë padisë dhe gjeti se të njëjtat janë të pa bazuara. E paditura nuk mund ta mënjanoi detyrimin, me pretendimin se detyrimet financiare nga Kontrata Kolektive Sektoriale se nuk prodhojnë efekt për shkak se nuk janë në harmoni me Ligjin mbi ndarjet buxhetore, gjykata vlerëson se këto akte, në këtë rast detyrimi nga neni 17 i Kontratës Kolektive Sektoriale, janë aprovuar nga struktura të larta të paditurës, e të cilët e kanë pasur për qëllim edhe motivimin e punonjësve për punë kur edhe kanë përcaktuar shpërblime për të njëjtit. Për më tepër derisa ato janë qartë të specifikuara nuk mund të interpretohen në dëm të tani paditësit duke u thirrur në mos ekzistimin e mundësive financiare, e as nuk mund të mbetet në diskrecionin e të paditurës se a mundet apo jo për tu përmbushur detyrimet që rezultojnë nga dispozitat lartcekura, përderisa e paditura me asnjë provë shkresore – analizë buxhetore, nuk e ka argumentuar faktin se ka bërë kërkesë për buxhet të veçantë për aprovimin e pagave të 13-ta për punonjësit e saj e jo të arsyetohet me arsyetim të pa argumentuar se ka mungesë të mjeteve buxhetore për përmbushjen e detyrimeve siç kanë kërkuar paditësi, për pjesën e aprovuar të kërkesës.

Andaj, bazuar në të gjitha të lartcekurat, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ashtu që paditësit për vitin 2018, 2019 dhe 2020 i ka njohur të drejtën e kompensimit për pagë të 13-të në lartësi prej 1,131€ ndërsa i ka refuzuar kërkesëpadinë për kompensimin e pagave të 13-ta për vitin 2021 dhe 2022 në lartësi prej 754€.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës në përgjigje në padi sa i përket pjesëve të aprovuara të kërkesë padisë dhe gjeti se të njëjtat janë të pa bazuara. E paditura nuk mund ta mënjanoi detyrimin, me pretendimin se detyrimet financiare nga Kontrata Kolektive Sektoriale se nuk prodhojnë efekt për shkak se nuk janë në harmoni me Ligjin mbi ndarjet buxhetore, gjykata vlerëson se këto akte, në këtë rast detyrimi nga neni 17 i Kontratës Kolektive Sektoriale, janë aprovuar nga struktura të larta të paditurës, e të cilët e kanë pasur për qëllim edhe motivimin e punonjësve për punë kur edhe kanë përcaktuar shpërblime për të njëjtit. Për më tepër derisa ato janë qartë të specifikuara nuk mund të interpretohen në dëm të tani paditësit duke u thirrur në

mos ekzistimin e mundësive financiare, e as nuk mund të mbetet në diskrecionin e të paditurës se a mundet apo jo për tu përmbushur detyrimet që rezultojnë nga dispozitat lartcekura, përderisa e paditura me asnjë provë shkresore – analizë buxhetore, nuk e ka argumentuar faktin se nuk ka pasur mundësi buxhetore apo se ka bërë kërkesë për buxhet të veçantë për aprovimin e pagave të 13-ta për punonjësit e saj si është e paraparë në kontratë Kolektive të nënshkruar nga vetë Qeveria e Kosovës përkatësisht Ministria e Shëndetësisë dhe e jo të arsyetohet me arsyetim të pa argumentuar se nuk ka pasur mundësi buxhetore për përmbushjen e detyrimeve siç kanë kërkuar paditësi për pjesën e aprovuar të kërkesës, për më tepër sa i përket mundësive buxhetore të të paditurës paditësit ka dorëzuar edhe raportin e auditimit për vitet përkatëse dhe nga e njëjta vërtetohet se e paditura ka pasur mundësin e përmbushjes së këtij detyrimi tek paditësit, por të njëjtin detyrim nuk e ka përmbushur.

Gjykata po ashtu morri parasysh dhe vlerësoi pretendimet e palës së paditur se baza e padisë nuk është më në fuqi pasi që në kohën e paraqitjes së padisë kontrata kolektive përkatëse nuk është më në fuqi edhe pse kontrata kolektive përkatëse nuk ka qenë në fuqi në kohën e paraqitjes së padisë detyrimet mbeten për kompensimin e pagave përcjellëse me rastin e pensionimit për ditë e punës sa ka qenë kontrata kolektive në fuqi. Andaj, nga të gjitha të lartcekurat dhe bazuar në dispozitat ligjore të cituara më lartë, gjykata ka vlerësuar se ka lindur e drejta e paditësit për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës për kompensim në pagave të 13-ta dhe se të njëjtat janë të legjitimuar që të kërkojë përmbushjen e këtij detyrimi nga ana e të paditurit.

Lidhur me kamatën, gjykata ka vendosur bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë me datë 23.11.2023 bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e bazoj në dispozitën e nenit 449 dhe 452, të LPK-së, sipas të cilave paditësi i pranohen shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumën prej 104 euro dhe në emër të taksës gjyqësore në shumën prej 31€ gjithsejtë shumën prej 135 euro.

Nga se u tha me lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

2023:249331 25.09.2024

**Gjyqtari
Bekim Salihu**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.